



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. DPK
 Dep. _____
 Nr. l faq. _____
 Broj stranica 02
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. 03-02/1408/18
 Prot No. _____
 Data _____
 Datum 14.05.2018
 Date _____

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.05.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3518/17, për z. Fatos Ajvazi, Prokuror në Prokurorinë Themelore të Prizrenit, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Fatos Ajvazi, Prokuror në Prokurorinë Themelore të Prizrenit dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private Sh.P.K “Antika 01”, Sh.P.K “Pizzeria Napoli”, Sh.P.K. “D- Group”, Sh.P.K. “Billbordat”, Sh.P.K. “Kartota Ads”, Sh.P.K. “Shkolla e Mesme Profesionale”, Sh.P.K. “Heron & Adea”, Sh.P.K. “Alta Group”, Sh.P.K. “Stroka – Kos”, Sh.P.K. “Isprigs”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari i lartë z. Fatos Ajvazi është njoftuar për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Fatos Ajvazi, është deklaruar se nga marrja e detyrës së Prokurorit në Prokurorinë Themelore të Prizrenit nuk e ushtron funksionin person i autorizuar në bizneset private të cekura më lartë, ndërsa gjendja ka mbetë e pandryshuar sepse pronarët e këtyre bizneseve nuk kanë marrë veprime për ta larguar nga funksioni person i autorizuar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve.

Agjencia kundër Korrupsionit i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë, me të cilën është kërkuar të heq dorë nga ushtrimi i funksionit person i autorizuar në bizneset private për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresat zyrtare me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni person i autorizuar në bizneset private të cekura më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

